



Zgjedhet Kryeshefi i ri në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë

Përfundon me sukses zgjedhja e Kryeshefit të ri të NPL "Stacioni i Autobusëve " SH.A. Prishtinë".

Është përmbyllur suksesshëm procesi i përzgjedhjes së Kryeshefit të ri të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve".

Bordi i Ndërmarrjes dhe përfaqësuesit e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar vlerësuan se i tërë procesi ka qenë i organizuar shumë mirë, me transparencë të plotë, dhe janë përzgjedhur më të mirët. Edhe paneli vlerësues, edhe përfaqësuesit e Ambasadës, kanë radhitur njësoj kandidatët që janë intervistuar.

Si rrjedhojë, në fund të këtij procesi, më së shumti pikë mori kandidati **Luan Hoti**. Ai tashmë është zgjedhur Kryeshef i NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.